



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency



Data: 21/11/2022 Ref.: 1968/22

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura të Republikës së Kosovës Nr.06/L-113 (GZ, Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr. 05/L-031 (GZ, Nr.20/12 Qershor 2016), Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Këshilli Shtetëror i Cilësisë (tutje KShC), në mbledhjen e 106-të, të mbajtur me datë 25.10.2022, mori:

### V E N D I M

- I. **Aprovohet** kërkesa e Universitetit të Prizrenit “Ukshin Hoti” nr.prot.1009/22 me datë 27.07.2022, **për plotësim/ndryshimin** e vendimit nr.Ref:950/22 i datës 18.07.2022.
- II. **Plotësohet/ndryshohet** vendimi nr.Ref:950/22 i datës 18.07.2022, në paragrafin I, ku pikës (një) I i shtohet teksti **“duke përfshirë edhe në gjuhët e komuniteteve boshnjake dhe turke”**.
- III. **Riakreditohet** programi i studimit në Universitetin “Ukshin Hoti” në Prizren, për periudhën pesë (5) vjeçare, 1 tetor 2022 - 30 shtator 2027:
  1. *Teknologji e Informacionit dhe Telekomunikim, BSc, 180 ECTS, maksimumi 180 studentë për vit akademik, duke përfshirë edhe në gjuhët e komuniteteve boshnjake dhe turke.*
- IV. Pjesa tjetër e vendimit nr.Ref:950/22 mbetet e pandryshuar.
- V. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

### A R S Y E T I M

- I. Universiteti “Ukshin Hoti” në Prizren ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim me nr.prot.1009/22 me datë 27.07.2022 për ndryshim-plotësim të vendimit mbi riakreditimin edhe të programeve të studimit në gjuhën turke dhe boshnjake.
- II. Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e 106 të mbajtur më 25.10.2022 ka shqyrtuar kërkesën dhe duke u bazuar në UA nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës nënparagrafi 5.3.10 të paragrafit 5 të nenit 26, ku: *“...Programet e studimit në gjuhët e komuniteteve (boshnjake dhe turke) në universitetet publike të Republikës së Kosovës të ofruara deri më tani, të cilat kanë mungesë të stafit akademik me gradën Dr.Sc., ashtu siç është përcaktuar me këtë UA, do të lejohen të ofrohen paralelisht me programet e akredituara në gjuhën shqipe, me kusht që brenda periudhës kalimtare prej pesë (5) vitesh, këto institucione të ngritin kapacitete vetanake të cilat sigurojnë qëndrueshmërinë e ofrimit të programit të studimit, sipas kërkesave të mësipërme të këtij udhëzimi. Të gjitha kërkesat tjera të vlerësimit të përcaktuara për akreditimin e programeve zbatohen sipas kërkesave të këtij UA”*, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

*Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në afatin prej 30 ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ. Inicimi i konfliktit administrativ apo çfarëdo procedure tjetër administrative nuk e pengon ekzekutimin e këtij vendimi.*

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi  
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cësësë